



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1090/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nexhmije Berishës, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), dega Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Nexhmije Berishës kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PD) dega Prishtinë.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Nexhmije Berisha kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PD) dega Prishtinë, në të cilën theksohet se beson dhe është e sigurtë se i janë manipuluar votat në këto Qendra Votimi QV 1920E, 1920X, 1919E, 1919X, 1921E, 1921X, 1956E, 1917e, si dhe thotë se kam dëshmi të komunës ku duhet të ceket se në ato vende ku kanë votuar familja ime nuk i kam votat. Ankesës parashtresja e saj thekson se i ka bashkangjitur disa dëshmi që i ka gjet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankimore të Nexhmije Berisha kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal, se i janë manipuluar votat në Qendrat e Votimit të lartshënuara, del se ankesa është e paqartë dhe e pakuptueshme pasi që në ankesën e saj nuk precizuar se cili ka qenë numri i votave në fillim për të cilën ajo pretendon dhe cili është numri i votave të shpallura nga QNR (KQZ), andaj PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.1090/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:***

Ndaj ketij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.